



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 793 Prot.

Tiranë, më 26. 11 2015

VENDIM Nr. 118, datë 18.11.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 46, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.14, të datës 18.11.2015, pasi shqyrtoi *Relacionin paraprak mbi dokumentimin e varreve* të hapura nga gërmimet klandestine në zonën e quajtur Sadovinë, Nekropoli i qytetit antik të Orikut-Vlorë, faza 1, 2 dhe 3, realizuar nga ASHA dhe DRKK Vlorë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Relacionin paraprak mbi dokumentimin e varreve* të hapura nga gërmimet klandestine në zonën e quajtur Sadovinë, Nekropoli i qytetit antik të Orikut-Vlorë, faza 1, 2 dhe 3, realizuar nga ASHA dhe DRKK Vlorë.
- II. Në vijim të vendimit të KKA Nr. 22 datë 11.03.2015, Instituti i Arkeologjisë-Misioni Shqiptaro Zvicerian, i cili ka kryer punime në këtë zonë, në kuadër të projektit kërkimor-shkencor "Orikumi", miratuar me vendim KKA nr. 310, datë 04.06.2014, të paraqesë propozimin për zgjerimin e zonës së mbrojtur arkeologjike Orikum-Vlorë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO